



REGJISTRIMI I PALIGJSHËM DHE NDARJA E VIDEOVE ME PËRMBAJTJE TË DHUNSHME

Ndarja e paligjshme e imazheve private dhe degraduese*, regjistrimeve audio dhe videove është një problem në rritje mes fëmijëve dhe të rinjve në Norvegji. Kur diçka është ndarë në internet, është shumë e vështirë për ta fshirë atë.

Ndarja e videove me përmbajtje të dhunshme nëpërmjet mediave sociale mund të shndërrohet në incidente edhe më të dhunshme, dhe nevoja për vëmendje mund ta bëjë dhunën më serioze. Me mediat sociale, praktikisht nuk ka kufizim se sa larg mund të përhapen imazhe të tilla.

A KENI MENDUAR NDONJËHERË ...

për faktin që ndarja e një videoje të një sulmi do të thotë që po e dëmton përsëri viktimën? për faktin që duke ditur se imazhet private dhe degraduese që po ndahen në internet mund të shtojnë ndjenjën e dhunimit të viktimës?

LIGJI ZBATOHET, MADJE EDHE NË TELEFONIN TUAJ CELULAR

Shumë fëmijë dhe të rinj nuk e njohin ligjin. Edhe pse shumica enjerzve e dinë se regjistrimi dhe ndarja e videove të dhunshme nuk është mirë, disa mund të mos e dinë se është edhe krim.

PO JU A JU KA NDODHUR?

- Kërkoni ndihmë. Flisni me një të rritur që i besoni.
- Shkrepni pamje ekrani dhe merrni dëshmi të asaj që ka ndodhur.
- Nëse merrni një video të dhunshme, mos e ndani atë. Fshijeni videon, përveç nëse është e nevojshme si dëshmi.
- Raportoni çështjen tek aplikacioni ose shërbimi i faqes së internetit.
- Nëse keni nevojë për këshilla, kontaktoni patrullën e policisë online ose policinë e rregullt në numrin e telefonit 02800.
- Ju mund të gjeni më shumë këshilla në faqet slettmeg.no dhe ung.no (vetëm në norvegjisht).

ÇFARË MUND TË BËJNË PRINDËRIT?

Nëse janë të shqetësuar për diçka që ka ndodhur në internet, fëmijët dhe të rinjtë duhet ta dinë se mund të flasin me prindërit e tyre ose të rriturit e tjerë ku kanë besim.

Bisedoni me fëmijët tuaj, tregoni mirëkuptim, bëjuni pyetje dhe tregojuni për pasojat e dhunës dhe ndarjes së videove të dhunshme. Kjo mund të bëjë që fëmija juaj të bëjë zgjedhjet e duhura.

politiet.no/deleerlikdelta

DELE= DELTA

